



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

**STRATEGJI E KUVENDIT PËR BASHKËPUNIM  
NDËRINSTITUCIONAL NË FUSHËN E  
POLITIKËS SË JASHTME**

*Janar 2019*

---



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

*Legjislatura VI*  
*Sesioni pranveror*

Kryesia e Kuvendit, në mbështetje të nenit 67.6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 18 janar 2019, me propozim të Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, miraton:

**STRATEGJINË E KUVENDIT PËR BASHKËPUNIM NDËRINSTITUCIONAL NË  
FUSHËN E POLITIKËS SË JASHTME**

**I. ANALIZË E BASHKËPUNIMIT AKTUAL NË FUSHËN E POLITIKËS SË  
JASHTME**

**1.1. Prioritetet e politikës së jashtme të Kosovës**

Politika e Jashtme është ndër shtyllat themelore të ndërtimit të shtetit. Për t'i forcuar aktivitetet ndërkombëtare, është e nevojshme të harmonizohen aktivitetet e Kuvendit të Kosovës, me qëllimet kryesore strategjike shtetërore të politikës së jashtme. Si rezultat i harmonizimit, Kosova mund të ndërmarrë veprime më efektive në fushën e marrëdhënieve me jashtë.

Republika e Kosovës synon të zbatojë një politikë të jashtme, e cila do të jetë në përputhje me qëllimet e qytetarëve të Kosovës për integrimet euroatlantike, konsolidimin e shtetit të Kosovës, ruajtjen dhe forcimin e marrëdhënieve me vendet mike, vendosjen e marrëdhënieve të mira me shtetet e rajonit, si dhe sigurimin e statusit të një partneri të besueshëm në luftën kundër kërcënimeve ndaj sigurisë ndërkombëtare.

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, strategjia e politikës së jashtme është fokusuar në njohjen e pavarësisë së saj nga shumica absolute e shteteve në arenën ndërkombëtare. Njohjet ndërkombëtare mbeten prioritet i institucioneve të Republikës së Kosovës. Veprimet shtetërore të Republikës së Kosovës, për realizimin e këtij prioriteti, janë zhvilluar në partneritet të ngushtë me SHBA-të, Britaninë e Madhe, Gjermaninë dhe Francën, aleatët e tjerë euroatlantik, si dhe aleatët rajonalë strategjik si Shqipëria. Në ditët e sotme, përparësia kryesore e strategjisë është modifikuar paksa. Aktualisht, politika e jashtme po përqendrohet në sigurimin e anëtarësimit në organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Me qëllim të përfundimit të procesit të njohjes ndërkombëtare, Ministria e Punëve të Jashtme përqendrohet në komunikimet diplomatike me shtete brenda dhe përtej Evropës, të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën. Në dritën e kësaj, njohja ndërkombëtare e pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës mbetet një prioritet për Ministrinë e Punëve të Jashtme, në raport me shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara, me qëllim të përmirësimit të pozitës ndërkombëtare të Kosovës dhe vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me shumicën dërrmuese të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara. Procesi i njohjes së Kosovës ka treguar që Kosova është një realitet i pakthyeshem dhe një faktor thelbësor për paqen dhe stabilitetin në rajon. Kosova synon të ketë marrëdhënie të mira diplomatike dhe fqinjësore në frymën evropiane. Përveç rritjes së numrit të njohjeve, mbetet prioritet vendosja e marrëdhënieve diplomatike me vendet që tashmë e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran. Marrëdhëniet diplomatike e forcojnë pozitën e Kosovës si një anëtar i plotë i bashkësisë ndërkombëtare. Përveç kësaj, këto marrëdhënie kanë potencialin për të sjellë përfitime të tjera të rëndësishme, të tilla si investimet e huaja dhe shkëmbimet tregtare. Për të rritur efikasitetin në veprimet për njohje të reja, është e nevojshme që të shtohet bashkërendimi në mes të institucioneve përgjegjëse të Republikës së Kosovës: Kuvendit, Qeverisë dhe Presidencës. Në këtë kontekst, MPJ duhet të luajë rolin kyç bashkërendues.

Qeveria e Kosovës, në programin e saj për vitet 2017-2021, është zotuar se do të investojë në fuqizimin dhe thellimin e partneritetit special me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si partneri më i rëndësishëm i Kosovës dhe të thellojë partneritetin strategjik me Shqipërinë, me qëllim të zhvillimit të raporteve të ngushta politike, ekonomike dhe kulturore. Kosova, sipas këtij programi, synon edhe ndërtimin e marrëdhënieve fqinjësore me Serbinë.

Qeveria, po ashtu, ka vendosur si synim të realizojë reformat e nevojshme, në mënyrë që të marrë statusin e shtetit kandidat për anëtarësim në BE deri në vitin 2020. Kosova, pa asnjë dilemë, synon anëtarësimin në NATO. Kosova është e vendosur të thellojë kontributin dhe angazhimin e saj në sigurinë rajonale. Kosova do të ushtrojë me përgjegjësi të plotë rolin e vet në koalicionin global kundër terrorizmit. Po ashtu, Kosova do të jetë aktive në ofrimin e kapaciteteve të veta. për të kontribuar krahas vendeve aleate për sigurinë globale.

Në anën tjetër, kontaktet me diasporën janë intensifikuar dhe është realizuar një bashkëpunim i shtuar. Po bëhen përpjekje për koordinim të mëtejshëm të aktiviteteve me diasporën, me qëllim të intensifikimit të investimeve të tyre në Kosovë dhe për të rritur përfshirjen e tyre në jetën politike, sociale dhe kulturore, duke marrë parasysh që kjo krijon një hapësirë gjithnjë e më të madhe që ata të bëhen aktorë të rëndësishëm në zhvillimin e Kosovës. Komisioni për Punë të Jashtme është duke mbikëqyrur për së afërmi të gjitha aktivitetet e Ministrisë së Diasporës, përfshirë procesin e konsultimeve publike me diasporën për hartimin e ligjit të ri të diasporës.

## **1.2. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit**

Më 1 prill 2016, ka hyrë në fuqi Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës. MSA-ja, që është thelbi i marrëdhënieve ndërmjet BE-së dhe Kosovës, është marrëdhënia e parë kontraktuale ndërmjet BE-së dhe Kosovës. Është një marrëveshje gjithëpërfshirëse, e cila siguron kornizën për dialogun politik dhe mbulon bashkëpunimin në një numër sektorësh, përfshirë këtu drejtësinë dhe punët e brendshme, tregtinë, arsimin, punësimin, energjinë, mjedisin dhe një sërë fushash të tjera të politikave. Me këtë marrëveshje kontraktuale, BE-ja dhe Kosova mund ta intensifikojnë bashkëpunimin në marrëdhëniet ndërmjet tyre.

Si marrëveshje ndërkombëtare, ajo përcakton mekanizmat dhe afatet zyrtare për zbatimin e të gjitha reformave që do ta përafrojnë Kosovën në mënyrë progresive me BE-në, në të gjitha fushat e politikave, deri në përmbushjen e të gjitha standardeve të BE-së. Për më tepër, MSA vendos kornizën e marrëdhënieve të Kosovës me shtetet anëtare dhe institucionet e BE-së për jetësimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA), deri në anëtarësimin e plotë në BE. Sa i përket fushëveprimit, përveç çështjeve politike e detyrimeve juridike (përfshirë ato që prekin rendin e brendshëm juridik), MSA i mbulon të gjitha sferat e qeverisjes.

Takimi inauguroes i Këshillit të parë të Stabilizim-Asociimit është mbajtur më 25 nëntor 2016. Në agjendë ishin prioritetet e reformave në fushat që përfshijnë sundimin e ligjit dhe reformat gjyqësore, respektimin e të drejtave themelore, reformën e administratës publike dhe reformat ekonomike.

Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (në tekstin e mëtutjeshëm: PKZMSA), është miratuar nga Qeveria, në dhjetor 2015 dhe nga Kuvendi i Kosovës në mars 2016. PKZMSA i pasqyron masat dhe prioritetet që rrjedhin nga mekanizmat politikë dhe politikat e marrëdhënieve Kosovë-BE, si dhe detyrat e përafrimit që rrjedhin nga *acquis* i BE-së.

Në nëntor 2016, Qeveria e Kosovës ka hartuar Agjendën e Reformës Evropiane (ARE), për të maksimizuar përfitimet ekonomike dhe politike të MSA-së. ARE luan një rol vendimtar në udhëheqjen e aktiviteteve rreth reformave në Kosovë. Dokumenti i përcakton prioritetet kyçe të vendit, të cilat e mbështesin përmbushjen e obligimeve që burojnë nga MSA-ja, në fushën e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, konkurrencës dhe klimës së investimeve dhe arsimit e punësimit.

#### *Dimensionimi parlamentar i MSA-së-Komisioni Parlamentar i Stabilizim-Asociimit*

Sipas neneve 15 dhe 132 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, dialogu politik në nivel parlamentar zhvillohet brenda kornizës së Komisionit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit (KPSA). Komisioni Parlamentar i Stabilizim-Asociimit është një forum për deputetët e Parlamentit Evropian (PE) dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës, për t'u takuar dhe për të diskutuar për çështjet me rëndësi. Komisioni Parlamentar i Stabilizim-Asociimit, si një organ i asociimit, luan një rol me rëndësi gjatë procesit të asociimit. Ky është takimi i nivelit më të lartë ndërmjet Parlamentit Evropian (PE) dhe vendit që synon aderimin.

Në vitin 2016, PE-ja dhe Kuvendi i Kosovës kanë themeluar Komisionin Parlamentar të Stabilizim-Asociimit (KPSA). Byroja e Parlamentit Evropian e ka miratuar Rregulloren e Punës, më 4 korrik 2016, ndërsa Kryesia e Kuvendit të Kosovës e ka miratuar atë më 10 gusht 2016.

Komisioni Parlamentar i Stabilizim-Asociimit është një komision i përbashkët, që përbëhet nga një numër i barabartë i anëtarëve të emëruar nga Parlamenti Evropian dhe nga Kuvendi i Kosovës. Deri tani, ky Komision ka mbajtur pesë takime të përbashkëta, dhe përveç në njërin, në të gjitha takimet e tjera ky komision i përbashkët ka arritur të miratojë deklarata, me të cilat janë pajtuar shumica e deputetëve të delegacionit të PE-së dhe shumica e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Takimi i radhës i KPSA është planifikuar të mbahet në shkurt 2019.

### **1.3. Raporti për Kosovën i Komisionit Evropian 2018**

Komisioni Evropian ka publikuar raportin për Kosovën, më 17 prill 2018. Sa i përket Kuvendit, raporti thekson se duhet të përmirësojë në masë substanciale punën e tij, si forum për dialog konstruktiv e përfaqësim politik, por edhe të garantojë kontrollet dhe baraspeshat e mirëfillta. Lidhur me Ratifikimin e marrëveshjes për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, thekson se ishte një zhvillim i rëndësishëm. Në raport, po ashtu theksohet se edhe koalicioni qeverisës, edhe opozita duhet të intensifikojnë punën e tyre parlamentare, si dhe të kërkojnë konsensusin mbi prioritetet e reformave që lidhen me BE-në.

Raporti nënvizon se mbikëqyrja e Kuvendit duhet përmirësuar e po ashtu edhe transparencja e cilësia e ligjvënies. Sa i përket përdorimit të procedurave të përsheptuara, raporti deklaron se kjo procedurë është aplikuar për 22 ligje dhe është miratuar legjislacion pa ndonjë debat substancial apo konsultim të palëve me interes, duke përfshirë edhe ligjet me rëndësi jetike, si ai buxhetit.

Raportet mëhershme të Komisionit Evropian kanë potencuar se Kryesia e Kuvendit ka miratuar një plan strategjik për periudhën 2016-2020, i cili përmban objektiva konkrete për të rritur aftësinë e Kuvendit, për ta përmbushur rolin e vet kushtetues. Një nga prioritetet e dokumentit është forcimi i diplomacisë parlamentare në nivel rajonal, evropian dhe ndërkombëtar.

### **1.4. Rezoluta e Parlamentit Evropian për Kosovën e vitit 2018**

Parlamenti Evropian ka miratuar Rezolutën, lidhur me raportin për Kosovën për vitin 2018 (2018/2149(INI), më dt. 29 nëntor 2018. Përmes kësaj rezolute, PE mirëpret miratimin e akteve të rëndësishme legjislative, në kudër të reformës evropiane dhe bën thirrje për zbatimin e tyre të plotë. Rezoluta vë në pah se reformat themelore po zbatohen ngadalë, në mungesë të konsensusit ndërpartiak, gjë që ka ndikuar negativisht në aftësinë e Kuvendit dhe Qeverisë, për të zbatuar reforma afatgjate dhe të qëndrueshme.

Parlamenti mirëpret të arriturat në fushën e administratës publike, duke theksuar nevojën për reforma të mëtejme, depolitizim dhe ristrukturim të administratës publike. Ratifikimin e marrëveshjes për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, në mars të vitit 2018, e mirëpret si një hap përpara për krijimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe nënvizon rëndësinë e këtij hapi për liberalizimin e vizave. Parlamenti Evropian, po ashtu ka shprehur shqetësimin për financim jo të duhur për gjyqësorin në Kosovë, për korrupsionin e përhapur, elementet e shtetit të kapur, influencën politike në gjyqësor dhe ka potencuar rëndësinë e reformave në sundimin e ligjit, me fokus të veçantë në pavarësinë dhe efikasitetin e gjyqësorit. Parlamenti Evropian thekson se pesë vende anëtare ende nuk e kanë njohur Kosovën dhe i fton ato që këtë ta bëjnë, ngase me këtë njohje do të kontribuonin në normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës e Serbisë.

### **1.5. Marrëveshja kuadër ndërmjet BE-së dhe Kosovës mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Kosovës në programet e Bashkimit Evropian**

Marrëveshja Kornizë ndërmjet BE-së dhe Kosovës mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Kosovës në programet e Bashkimit Evropian, e lidhur më 25 nëntor 2016, krijon të drejtën e Kosovës për pjesëmarrje në programet e Bashkimit Evropian, në përputhje

me zotimet e saj, për të miratuar dhe zbatuar standardet relevante në fushat përkatëse të programit në fjalë dhe progresin e bërë në këtë drejtim.

Sipas nenit 2 të kësaj marrëveshjeje, Kosova do të kontribuojë financiarisht në buxhetin e përgjithshëm të BE-së, proporcionalisht me programet e veçanta të BE-së, në të cilat merr pjesë.

Projektet dhe iniciativat e dorëzuara të pjesëmarrësve nga Kosova, për aq sa është e mundur, do t'u nënshtrohen kushteve, rregullave dhe procedurave të njëjta që iu takojnë programeve në fjalë të BE-së, ashtu siç aplikohen për shtete anëtare.

Sipas kësaj marrëveshjeje, përfaqësuesit e Kosovës lejohen të marrin pjesë, si vëzhgues dhe për pikat që kanë të bëjnë me Kosovën, në komitetet menaxhues që janë përgjegjëse për monitorimin e programeve të Bashkimit Evropian, në të cilat Kosova kontribuon financiarisht.

## **1.6. Objektivat e politikës së jashtme në Programin e Qeverisë për vitet 2017-2021**

Sipas Programit të Qeverisë për vitet 2017-2021, janë paraqitur objektivat e politikës së jashtme si vijon:

1. Riorganizimi i MPJ-së dhe t të jashtëm, ngritja profesionale e personelit diplomatik, dinamizmi i punës në MPJ dhe ngritja e eficiencës;
2. Intensifikimi i veprimeve për krijimin e mundësive reale për liberalizimin e vizave;
3. Intensifikimi i veprimeve për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë;
4. Vazhdimi dhe intensifikimi i veprimeve për rritjen e numrit të njohjeve ndërkombëtare të Kosovës në botë;
5. Intensifikimi i veprimeve, për krijimin e mundësive për integrimin e Kosovës në BE dhe organizata tjera evropiane;
6. Ngritja dhe fuqizimi i bashkëpunimit me NATO-n dhe mekanizmat tjerë euroatlantikë;
7. Intensifikimi dhe kultivimi i mëtutjeshëm i marrëdhënieve dypalëshe;
8. Intensifikimi dhe kultivimi i mëtutjeshëm i marrëdhënieve shumëpalëshe;
9. Fuqizimi dhe thellimi i partneriteteve strategjike;
10. Promovimi dhe rritja e bashkëpunimit rajonal;
11. Intensifikimi dhe fuqizimi i diplomacisë ekonomike, diplomacisë publike dhe diplomacisë parlamentare;
12. Reformimi i shërbimit të jashtëm;
13. Shërbimet digjitale konsullore.

## **1.7. Qëllimi i diplomacisë parlamentare**

Diplomacia parlamentare është instrument i rëndësishëm i politikës së jashtme të një vendi, është një formë alternative, plotësuese e diplomacisë. Me pjesëmarrjen aktive të anëtarëve të Kuvendit (deputetëve), në forumet dhe aktivitetet e ndryshme ndërkombëtare, ata mund të kontribuojnë në përfaqësimin e interesave të vendit, në fushën ndërkombëtare. Përgjithësisht, diplomacia parlamentare nuk është dyfishim apo zëvendësim i diplomacisë qeveritare tradicionale, por përmes mjeteve të saj kontribuon në kapacitetet më të mira avokuese të vendit.

Deputetët, si nga radhët e partive në pushtet ashtu edhe nga radhët e opozitës, mund të ndërtojnë ura ndërmjet palëve të ndryshme të interesit dhe mund të arrijnë rezultate për

interesat e vendit. Diplomacia parlamentare mund ta plotësojë në mënyrë efektive diplomacinë qeveritare, pasi që deputetët mund të jenë më fleksibilë në aktivitetet e tyre. Zëri i vendit mund të dëgjohet më shumë përmes forumeve të ndryshme ndërparlamentare.

Organizatat parlamentare dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë parlamentarë duhet të shfrytëzohen nga Kuvendi i Kosovës, për të përçuar mesazhin tonë në nivele ku Qeveria e Kosovës nuk arrin ta bëjë këtë. Realizimi i qasjeve të veçanta dhe krijimi i lidhjeve me këto organizata dhe mekanizma shumëpalësh, për afirmim dhe njohje të Kosovës, si subjekt ndërkombëtar, mbetet prioritet i diplomacisë parlamentare. Realizimi i suksesshëm i këtyre orientimeve strategjike, parakupton veprime sistematike dhe të bashkërenduara në vijën institucionale, të mbështetura sidomos nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe rrjeti i shërbimit të jashtëm.

## **II. PJESËMARRJA AKTUALE E KUVENDIT NË FORMËSIMIN E POLITIKËS SË JASHTME – BASHKËPUNIMI ME AKTORËT QEVERTARË DHE AKTORËT TJERË NË FUSHËN NDËRKOMBËTARE**

### **2.1. Aktorët kryesorë të Kuvendit të Kosovës në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe marrëdhëniet ndërparlamentare**

#### **2.1.1. Aktorët kryesorë politikë**

##### *Roli i Kryetarit dhe Kryesisë së Kuvendit*

Kryetari i Kuvendit ka rol në përfaqësimin e Kuvendit të Kosovës në takimet brenda dhe jashtë vendit. Sipas rregullave aktuale (Ligji për protokollin shtetëror – LPSH, neni 26), Kryetari i Kuvendit është autoriteti i dytë në radhën e përparësisë në Republikën e Kosovës.

Për më tepër, sipas Rregullores së Punës (Neni 15, paragrafët 9, 10, 12) Kryesia e Kuvendit ka një rol kyç në marrjen e vendimeve për aktivitetet ndërkombëtare:

- a. Kryesia zhvillon marrëdhënie të jashtme parlamentare dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare nga fusha e përgjegjësisë së saj;
- b. Kryesia i shqyrton kërkesat dhe vendos për udhëtimet jashtë vendit të delegacioneve e të deputetëve, për ta përfaqësuar Kuvendin;
- c. Kryesia e miraton projektbuxhetin e Kuvendit, që përgatitet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, në bashkëpunim me administratën e Kuvendit.

*Neni 75 i Rregullores së Kuvendit* e përcakton dokumentacionin e nevojshëm për vizitat zyrtare. Delegacioni i Kuvendit, i cili udhëton zyrtarisht jashtë shtetit, njofton me shkrim brenda dy javëve, pas kthimit dhe njoftimi i dërgohet Kryesisë së Kuvendit.

Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës i përcakton kompetencat e ndryshme që mund të ushtrohen nga deputetët apo në kuadër të forumeve dhe mjeteve të tjera parlamentare.

##### *Roli i Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike*

Neni 65 i Kushtetutës e garanton mbikëqyrjen e politikës së jashtme të Qeverisë nga ana e Kuvendit.

Sipas Rregullores së Kuvendit (Shtojca 2, paragrafi 5), Komisioni për Punë të Jashtme posedon kompetenca të veçanta në koordinimin e çështjeve ndërkombëtare të Kuvendit. Komisioni e ndërton bashkëpunimin me parlamentet e shteteve të tjera dhe e promovon anëtarësimin e Kuvendit në organizatat parlamentare rajonale e ndërkombëtare. Komisioni rekomandon për ratifikim traktatet ekzistuese ndërkombëtare, të cilat Kosova dëshiron t'i nënshkruajë dhe bën përcjelljen e negociatave të udhëhequra nga Qeveria, për bashkëpunime të saj në traktatet e reja dhe e nis debatin për ratifikimin e tyre.

Po ashtu, komisioni, sipas Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe plotësimin e ndryshimin e tij, ka në kompetencë që të gjithë të propozuarit e Qeverisë për udhëheqës të misionëve diplomatike t'i dëgjojë në seanca të mbyllura dëgjimore, si dhe të përgatit raport nga dëgjimi në besim për Presidentin, Kryeministrin dhe Ministrin e MPJ-së.

Komisioni promovon diplomacinë parlamentare të Kuvendit dhe shqyrton edhe buxhetin e resorëve përkatës që i ka nën mbikëqyrje. Komisioni mund ta shoqërojë Kryetarin e Kuvendit në takimet ndërparlamentare, si dhe Ministrin e Jashtëm në takimet e caktuara të rëndësishme. Në fushëveprimin dhe përgjegjësitë e Komisionit për Punë të Jashtme, përcaktohen disa nga funksionet që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e politikës së jashtme të Qeverisë, përfshirë këtu ligjvënien, negociatat, implementimin e politikave dhe aktivitetet diplomatike dhe vendimet financiare. Në ushtrimin e funksioneve, komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës, me rrjetin diplomatik të Kosovës dhe me të gjitha ministrinë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke i përfshirë edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga komisioni.

Në këtë legjislaturë, me vendim të Kuvendit, komisioni është ngarkuar që përveç fushës së marrëdhënieve me jashtë, po ashtu të përfshijë edhe portofolin e Diasporës dhe Investimeve Strategjike dhe të mbikëqyrë politikat dhe vendimet e Qeverisë në këto fusha.

#### *Roli i Komisionit për Integritim Evropian (KIE)*

Komisioni për Integritim Evropian, në kuadër të fushëveprimit dhe të përgjegjësiave të tij, e shqyrton dhe e mbikëqyr procesin e harmonizimit të çdo ligji të miratuar në Kuvend, me legjislativën e Bashkimit Evropian. Fushëveprimi i këtij Komisioni, përfshin, gjithashtu, bashkëpunimin dhe koordinimin e punëve me institucionet e Bashkimit Evropian, në drejtim të integritimit dhe të anëtarësimin të Kosovës në Bashkimin Evropian. Komisioni bashkëpunon dhe shkëmben përvojat me shtetet e BE-së dhe me shtetet e tjera, për qëllimet e integritimit në BE; bashkëpunon dhe i koordinon punët me institucionet evropiane në Kosovë. Kompetencat kryesore të komisionit janë: Mbikëqyrja e punës së Qeverisë në përmbushjen e detyrimeve të marra nga institucionet e Kosovës dhe sidomos detyrimet e Kuvendit ndaj institucioneve të Bashkimit Evropian;

- Mbikëqyrja e Procesit të Stabilizimit dhe të Asociimit të Kosovës;
- Mbikëqyrja dhe koordinimi i Instrumentit të Paraanëtarësimin (IPA) për Kosovën;
- Monitorimi i programeve të donatorëve dhe i programeve të bashkëpunimit të BE-së, të dedikuara për Kosovën;
- Bashkëpunimi me institucionet përkatëse në procesin e anëtarësimin të Kosovës në Këshillin e Evropës; mbikëqyrja e zbatimit të detyrave të Kosovës, që dalin nga konventat e Këshillit të Evropës dhe mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve të Këshillit të Evropës për Kosovën.

Për ushtrimin e funksioneve të tij, komisioni bashkëpunon me Zyrën e Kryeministrit, me institucionet tjera përkatëse dhe me të gjitha ministrinë, nga të cilat komisioni mund të kërkojë



të dhëna konkrete, duke i përfshirë këtu edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga komisioni.

### *Grupet e miqësisë në Kuvendin e Kosovës*

Me propozim të Komisionit për Punë të Jashtme dhe Vendim të Kryesisë së Kuvendit, në dhjetor 2017, janë riformuar 46 grupe të miqësisë dhe janë formuar edhe 10 grupe të reja. Shumica e grupeve të miqësisë janë funksionale, ndërkaq për një numër të tyre priten ende të dërgohen emrat e deputetëve nga grupet parlamentare, në mënyrë që të funksionalizohen. Grupet e miqësisë që janë riformuar janë si vijon:

1. Grupi i Miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës,
2. Grupi i Miqësisë me Mbretërinë së Bashkuar,
3. Grupi i Miqësisë me Gjermaninë,
4. Grupi i Miqësisë me Francën,
5. Grupi i Miqësisë me Italinë
6. Grupi i Miqësisë me Zvicrën,
7. Grupi i Miqësisë me Vatikanin,
8. Grupi i Miqësisë me Turqinë,
9. Grupi i Miqësisë me Tunizinë,
10. Grupi i Miqësisë me Suedinë,
11. Grupi i Miqësisë me Spanjën,
12. Grupi i Miqësisë me Slloveninë,
13. Grupi i Miqësisë me Sllovakinë,
14. Grupi i Miqësisë me Shqipërinë,
15. Grupi i Miqësisë me Rumaninë,
16. Grupi i Miqësisë me Qipron,
17. Grupi i Miqësisë me Portugalinë,
18. Grupi i Miqësisë me Poloninë,
19. Grupi i Miqësisë me Maqedoninë,
20. Grupi i Miqësisë me Maltë,
21. Grupi i Miqësisë me Malin e Zi,
22. Grupi i Miqësisë me Malajzinë,
23. Grupi i Miqësisë me Estoninë,
24. Grupi i Miqësisë me Belgjikën,
25. Grupi i Miqësisë me Luksemburgun,
26. Grupi i Miqësisë me Lituaninë,
27. Grupi i Miqësisë me Letoninë,
28. Grupi i Miqësisë me Kuvajtin,
29. Grupi i Miqësisë me Kroacinë,
30. Grupi i Miqësisë me Katarin,
31. Grupi i miqësisë me Kanadanë,
32. Grupi i Miqësisë me Japoninë,
33. Grupi i Miqësisë me Irlandën,
34. Grupi i Miqësisë me Hungarinë,
35. Grupi i Miqësisë me Holandën,
36. Grupi i Miqësisë me Finlandën,
37. Grupi i Miqësisë me Emiratet e Bashkuara Arabe,
38. Grupi i Miqësisë me Egjiptin,
39. Grupi i Miqësisë me Danimarkën,

40. Grupi i Miqësisë me Bullgarinë,
41. Grupi i Miqësisë me Austrinë,
42. Grupi i Miqësisë me Greqinë,
43. Grupi i Miqësisë me Arabinë Saudite,
44. Grupi i Miqësisë me Panamanë,
45. Grupi i Miqësisë me Ganën,
46. Grupi i Miqësisë për Australi, Zelandë të Re dhe shtetet e tjera të Oqeanisë.

Ndërkaq, grupet e reja të propozuara nga Komisioni për Punë të Jashtme dhe të miratuara nga Kryesia, por që ende nuk janë finalizuar, sepse nuk janë dërguar emrat nga grupet parlamentare, janë si vijon:

1. Grupi i Miqësisë me Republikën e Çekisë,
2. Grupi i Miqësisë me Republikën e Koresë,
3. Grupi i Miqësisë me Norvegjinë dhe Islandën,
4. Grupi i Miqësisë me Tajlandën,
5. Grupi i Miqësisë me Bosnjë e Hercegovinën,
6. Grupi i Miqësisë me Izraelin,
7. Grupi i Miqësisë me Jordaninë,
8. Grupi i Miqësisë për Afrikën Veriore,
9. Grupi i Miqësisë për Afrikën Qendrore e Jugore,
10. Grupi i Miqësisë për vendet e Lindjes së Afërt.

Grupet e miqësisë janë mjet shumë i rëndësishëm i diplomacisë parlamentare, të cilat me punën e tyre mund të hapin dyer, që mund të jenë të mbyllura për ekzekutivin. E kaluara tregon se edhe te shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën, është shumë më lehtë të bashkëpunohet me parlamentet dhe në këtë kontekst, grupet e miqësisë mund të krijojnë afërsinë e nevojshme nëpërmjet dimensionit parlamentar të bashkëpunimit ndërmjet shteteve. Kuvendi duhet të përkrahë, edhe me buxhet, punën e grupeve të miqësisë, dhe po ashtu të miratojë vizitat e nevojshme, ndërkaq Ministria e Punëve të Jashtme, nëpërmjet rrjetit diplomatik, duhet të punojë që të krijohen grupe homologe të miqësisë në shtete të ndryshme, me të cilat Kosova ka interes të zhvillojë raporte bilaterale.

### ***2.1.2. Aktorët administrativë në nivel të stafit***

#### *Roli i Drejtorisë për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare (DPMN)*

Drejtorja ka për detyrë të ofrojë përkrahje profesionale për anëtarët e Kuvendit në themelimin dhe forcimin e aktiviteteve ndërparlamentare, në nivel dypalësh dhe shumëpalësh. Drejtorja, gjithashtu, duhet të ofrojë përkrahje për realizimin e aktiviteteve të ndryshme parlamentare (p.sh., organizimi i konferencave) nën kujdesin e Kryetarit të Kuvendit, anëtarëve të Kryesisë, apo të komisioneve parlamentare. Përveç kësaj, drejtorja merr pjesë në përgatitjen dhe organizimin e vizitave ndërkombëtare të Kryetarit, të Kryesisë, të deputetëve, të grupeve parlamentare dhe të administratës së Kuvendit. Drejtorja është përgjegjëse, gjithashtu, për të gjitha detyrat organizative në lidhje me pritjen e delegacioneve të huaja. Drejtorja për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare përbëhet nga Njësia e Protokollit dhe Njësia e Marrëdhënieve Ndërkombëtare.

Për momentin, drejtorja nuk mban bazë të dhënash apo një sistem të arkivimit, ku mund të arkivohen dhe të ruhen të gjitha shënimet dhe të dhënat për aktivitetet e ndryshme

ndërkombëtare të Kuvendit, gjë që është e domosdoshme për të krijuar memorie institucionale në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar nga ana e Kuvendit të Kosovës.

### *Roli i sekretariateve të komisioneve*

Vizitat efikase të komisioneve jashtë vendit, kontribuojnë në realizimin e synimeve të përcaktuara të politikës së jashtme. Sekretariatet do të duhet t'i mbulojnë të gjitha detyrat në lidhje me vizitat jashtë vendit, sa herë që e shoqërojnë një delegacion të komisionit (përfshirë këtu çështjet teknike dhe përmbajtjesore dhe vazhdimësinë e punës në komisionet përkatëse, dhe ofrimin e përkrahjes administrative për deputetët). Këto sekretariate do të duhej të funksiononin në veçanti për organizimin e vizitave të Komisionit për Punë të Jashtme.

## **2.2. Bashkëpunimi me aktorët qeveritarë dhe aktorët tjerë në fushën ndërkombëtare**

### **2.2.1. Ministria e Punëve të Jashtme**

Misioni i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës është të formulojë dhe të zbatojë politikën e jashtme të Kosovës, të mbrojë interesat e Kosovës, përballë vendeve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare.

Detyrë e ministrisë është, gjithashtu, përfaqësimi i Kosovës jashtë vendit, ruajtja dhe mbrojtja e imuniteteve dhe e privilegjeve të misioneve diplomatike dhe të personave, në përputhje me ligjet dhe konventat ndërkombëtare, zhvillimi dhe koordinimi i politikave në raport me vendet tjera. Ministria e Punëve të Jashtme, gjithashtu, i promovon dhe i mbron politikat kombëtare kulturore dhe ekonomike të Kosovës.

Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës, sipas programit të saj, është e përkushtuar për mbrojtjen dhe sigurinë e pavarësisë së vendit, për mbrojtjen e interesave shtetërore në arenën ndërkombëtare, për promovimin e interesave politike dhe ekonomike të Kosovës, si dhe për mbrojtjen dhe përfaqësimin e të drejtave dhe interesave të qytetarëve të saj. Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës, lehtëson njohjen e Kosovës në komunitetin ndërkombëtar. Në këto përpjekje, vëmendje e veçantë i kushtohet partneritetit strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkimin Evropian dhe me NATO-n.

Ministria e Punëve të Jashtme, për fushëveprimin e saj, i raporton rregullisht Komisionit për Punë të Jashtme të Kuvendit të Kosovës, dhe në përputhje me procedurat e Kuvendit, mund të raportojë edhe në seancë plenare apo sipas kërkesës së komisioneve të tjera. Ministri ftohet në raportim në Komision për Punë të Jashtme, disa herë në vit. Për më tepër, ministria duhet të përfshijë Komisionin për Punë të Jashtme të Kuvendit të Kosovës, në takime dhe vizita të ndryshme (p.sh: në takimet me Ambasadorët e akredituar në Kosovë, në delegacione të tjera që vizitojnë Kosovën, ose duke i ofruar informata për vizitat e tjera të rëndësishme ndërkombëtare).

Për sa u përket materialeve mbështetëse, ministrisë i kërkohet të përgatisë skedarë dhe profile të ndryshme, të cilat Kuvendi i shfrytëzon si materiale përgatitëse për vizitat jashtë vendit apo në rast të vizitave të delegacioneve nga jashtë. Ministria e Punëve të Jashtme do të duhej të mbështeste zhvillimin e diplomacisë parlamentare, duke ndarë me kohë planin e vizitave, duke ftuar Komisionin për Punë të Jashtme të jetë pjesë e këtyre vizitave, rregullisht, duke

ndarë me Komisionin informata rreth rezultateve në raportet bilaterale dhe multilaterale dhe duke i dhënë komisionit rekomandime konkrete rreth vizitave. Për shkak të kufizimeve buxhetore të Kuvendit, do të ndihmonte nëse ministria në buxhetin e vizitave parasheh buxhet edhe për përkrahjen e diplomacisë parlamentare. MPJ duhet të përfshijë Kuvendin, respektivisht anëtarët e Komisionit për Punë të Jashtme, në grupet punuese për lobim, për njohje dhe hartimin e strategjive për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Dimensioni parlamentar mund të ndikojë pozitivisht, sidomos në anëtarësimin në organizatat, të cilat kanë Asamble Parlamentare, si Këshilli i Evropës, NATO, SEECP, CEI etj.

Po ashtu, duke i marrë për bazë synimet strategjike të Kosovës, përfshirja e diplomacisë parlamentare do të duhej të ishte një element thelbësor i aktiviteteve të Akademisë Diplomatike.

### ***2.2.2. Ministria e Integritit Evropian***

Ministria e Integritit Evropian (MIE), është themeluar në vitin 2010. MIE ka si mision kryesor drejtimin, koordinimin dhe monitorimin e të gjitha aktiviteteve drejt integritit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian dhe aktivitetet e saj i mbulojnë këto fusha:

- Përgatitja dhe monitorimi i dokumenteve strategjike për përmbushjen e kriterëve dhe të obligimeve që dalin nga procesi i integritit evropian. Kjo përfshin përgatitjen e këtyre dokumenteve dhe harmonizimin e tyre me dokumentet tjera strategjike të Qeverisë. MIE organizon, gjithashtu, përgatitjen dhe prezantimin e dokumenteve relevante sipas organizatave të linjës, sipas afateve të përcaktuara nga procesi i integritit.
- Asistenca dhe organizimi i mekanizmave për koordinim të donatorëve. Për këtë qëllim, MIE synon të harmonizojë asistencën e jashtme me agjendën evropiane të Kosovës. Në këtë kontekst, koordinimi, programimi dhe monitorimi i programeve të asistencës së BE-së për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me prioritetet e vendit. Me këto programe, MIE i përgatit dhe i nënshkruan marrëveshjet për asistencë financiare nga BE-ja, në emër të Republikës së Kosovës.
- Koordinimi, monitorimi dhe analiza e procesit të harmonizimit të legjislacionit vendor me atë të BE-së, vlerësimi i pajtueshmërisë së këtij legjislacioni me ligjet e BE-së, si dhe koordinimi i përkthimit të legjislacionit të BE-së për nevojat e harmonizimit të legjislacionit vendor me ligjet e BE-së.
- Në bashkëpunim me institucionet tjera përgjegjëse, MIE e bën përgatitjen dhe koordinimin e procesit për zhvillim të kapaciteteve në fushën e integritit evropian, duke e mundur funksionimin e institucioneve efikase, që janë në gjendje të tërheqin dhe të mbajnë profesionistë të talentuar, duke dhënë një shembull pozitiv të institucioneve me standarde profesionale dhe menaxhuese.
- Themelimi i programit të komunikimit me publikun, lidhur me çështjet e integritit evropian, për të siguruar që qytetarët e Kosovës janë të mirinformuar për integritimin evropian.

Ministria mban kontakte të drejtpërdrejta me Kuvendin, me anë të një pike kontaktuese joformale. Korrespondenca është më intensive në periudhën e raportimit. Ministria ofron, por edhe kërkon informata nga Kuvendi, përmes pikës joformale të kontaktit. Nëse kërkohen materiale mbështetëse nga Kuvendi, kryesisht nga Komisioni për Integritim Evropian, ministria i dërgon materialet përkatëse.

### ***2.2.3. Këshilli Kombëtar për Integritim Evropian***

Për të ecur përpara në rrugën e integritimit evropian, Presidentja e Republikës së Kosovës ka krijuar Këshillin Kombëtar për Integritim Evropian në vitin 2012. Këshilli miratoi në vitin 2013 Strategjinë Kombëtare për Procesin e Integritimit Evropian - Kosova 2020. Shoqëria civile, fusha akademike, sektori i biznesit dhe partitë politike u përfshinë në këtë proces. Kjo strategji është miratuar nga të gjitha grupet politike të përfaqësuara në atë kohë në Kryesinë e Kuvendit. Takimet e Këshillit Kombëtar për Integritim Evropian, thirren nga Presidenti i Republikës, dy herë në vit.

### ***2.2.4. Konkluzion***

Aktualisht, mund të konkludohet që ekziston një lloj bashkëpunimi ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë, në formimin, ndikimin dhe kontrollin e politikës së jashtme të vendit, por nuk është një mekanizëm i rregullt (përkundrazi i bazuar në baza *ad-hoc*) dhe konsultativ. Për t'u arritur kjo, është esenciale që dikasteret qeveritare, që mbulojnë fushën e politikës së jashtme, të kuptojnë drejt obligimin e tyre kushtetues, për t'i raportuar rregullisht Kuvendit dhe t'i përgjigjen pozitivisht ftesave të komisioneve përkatëse ose kërkesave të deputeteve në seanca plenare (qoftë për pyetje parlamentare apo për interpelanca e debate).

Nëse shqyrtohen, në hollësi, rregullat dhe legjislacioni aktual, konkluzioni është që drejtimet kryesore të zbatimit të prioriteteve të politikës së jashtme, deri diku, përputhen me njëra-tjetrën. Megjithatë, duhet të arrihet një koordinim dhe bashkëpunim më efektiv dhe i strukturuar, brenda Kuvendit dhe gjithashtu me aktorët përkatës qeveritarë. Koordinimi është tejet me rëndësi, në mënyrë që institucionet e Kosovës mos të dalin me qëndrime të çakorduara për çështje të politikës së jashtme. Në rast të koordinimit më të mirë dhe përdorimit të instrumenteve të ndryshme të diplomacisë parlamentare, suksesi i politikës së jashtme mund të shumëfishohet në perspektivën afatshkurtër dhe atë afatgjatë. Një nga prioritetet kyçe të strategjisë aktuale të politikës së jashtme është sigurimi i anëtarësimit të plotë në organizatat ndërkombëtare. Disa organizata ndërkombëtare kanë dimensionin e tyre parlamentar, kështu që Kuvendi duhet t'i shfrytëzojë këto rrjete, për të lehtësuar realizimin e qëllimeve strategjike të politikës së jashtme të Kosovës. Për këtë qëllim, Komisioni për Punë të Jashtme, është duke përgatitur rekomandim për Kuvendin, për të aplikuar për anëtarësim në disa asamble parlamentare, në kuadër të organizatave ndërkombëtare. Dimensioni parlamentar duhet të zhvillohet, sidomos në ato vende të cilat hezitojnë të vënë kontakte të rregullta me nivelin ekzekutiv. Por, ky bashkëpunim dhe bashkërendim, mund të ndodhë gjithmonë vetëm nëse ka bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe rrjetin e shërbimit të jashtëm.

### **III. PROPOZIMET PËR STRATEGJINË E BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL NË FUSHËN E POLITIKËS SË JASHTME**

#### **3.1. Forcimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me Bashkimin Evropian**

##### ***3.1.1. Komisioni Parlamentar për Stabilizim dhe Asociim***

Neni 132 i MSA-së, përcakton qartë rolin dhe funksionet e KPSA BE-Kosovë. Ndikimi kryesor i KPSA-së BE-Kosovë, qëndron në miratimin e deklaratave dhe rekomandimeve, të cilat sillen në vëmendjen e Qeverisë dhe të dy parlamenteve, si dhe të Komisionit Evropian.

Kompleksiteti i detyrave përpara Kuvendit, kërkon ndarje të qartë të funksioneve dhe të përgjegjësi ndërmjet KIE-së dhe delegacionit të Kosovës në KPSA, për të shmangur çdo mbivendosi të panevojshme në funksionimin e këtyre dy organeve dhe njëkohësisht duke siguruar që të gjitha detyrat që dalin nga procesi i MSA-së janë të mbuluara siç duhet.

Takimet e KPSA-së duhet të përgatiten me dokumentacionin përcjellës përkatës. Interesi kombëtar duhet të pajtohet paraprakisht dhe të përfaqësohet në takime. Për të përfaqësuar interesin kombëtar në nivelin më të lartë, përfaqësuesit politikë synojnë ndërtimin e konsensusit midis tyre, para mbajtjes së takimeve.

Shembulli i vendeve të anëtarësuar kohët e fundit ka treguar që konsensusi me bazë të gjerë mundëson arritjen e rezultateve më të mira në rrugën e integritit në BE. Interesi kombëtar mund të përfaqësohet në mënyrë më efektive, nëse të gjithë e mbështesin atë. Duke i marrë parasysh aktivitetet e rregullta të kohëve të fundit të KPSA-së, si dhe rolin dhe përgjegjësitë e KIE-së, por edhe nevojën e shtuar për ndërtimin e konsensusit në çështjet e BE-së, do të ishte me vlerë të merret parasysh zgjerimi gradual i delegacionit të Kosovës në KPSA, në një forum konsultimi parlamentar të nivelit të lartë për diskutimin e çështjeve strategjike rreth procesit të integritit në BE. Forumi i konsultimeve mund të shërbejë si një mjet efikas për të krijuar konsensus kombëtar mbi perspektivën evropiane të Kosovës dhe për të garantuar koordinimin e nivelit më të lartë në mes të Kuvendit dhe Qeverisë, në çështjet e BE-së.

Deri tani, KPSA ka mbajtur 5 takime të përbashkëta, ku kanë marrë pjesë delegacioni i Kuvendit të Kosovës dhe delegacioni i Parlamentit Evropian. Përpos në njërin nga takimet, në të gjitha takimet e tjera janë miratuar deklarata të përbashkëta të dy delegacioneve, në kuadër të KPSA-së. Takimi i radhës planifikohet të mbahet në shkurt 2019.

##### ***3.1.2. Bashkëpunimi tjetër me Parlamentin Evropian***

*Takimet ndërparlamentare që organizohen nga Parlamenti Evropian*

Takimet e komisioneve ndërparlamentare (TKNP), i bëjnë bashkë deputetët nga komisionet përkatëse të PE-së dhe të parlamenteve kombëtare, me iniciativën e një ose më shumë komisioneve parlamentare të PE-së. Këto takime, kryesisht mbulojnë fushat ku BE-ja është kompetente, për të vepruar në bazë të procedurës së zakonshme legjislative. Katër anëtarë nga çdo parlament kombëtar, mund të marrin pjesë në takim, dhe në përgjithësi, përkthimi ofrohet në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së. Të gjithë anëtarët e komisionit përkatës të PE-së mund të marrin pjesë në takime. Qëllimi i TKNP-së është të promovojë shkëmbimin e pikëpamjeve midis PE-së dhe parlamentarëve kombëtarë. Gjatë dy viteve të fundit, janë organizuar shumë takime të tilla. PE organizon, në përgjithësi, të paktën 5-6 TKNP për semestër me miratimin e

Konferencës së Presidentëve të PE-së. Komisioni për Punë të Jashtme ftohet rregullisht dhe merr pjesë (me ftesë të Komisionit për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian dhe Komisionit për Punë të Jashtme të vendit anëtar që e udhëheq Presidencën në atë periudhë përkatëse), në takimet për politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë.

Kalendari i TKNP-ve është në dispozicion në faqen e internetit të PE-së. Në rast të interesit të veçantë dhe arsyes politike, Kuvendi i Kosovës mund të kërkojë një ftesë në baza ad-hoc, në varësi të rendit të ditës, në mënyrë që të jetë i njoftuar me sfondin e këtyre takimeve. Këto takime mund të jenë një bazë e duhur dhe një rast i shkëlqyer i atyre vizitave që duhet të organizohen në fazën e mëvonshme të procesit të aderimit. Përveç kësaj, në margjinat e këtyre takimeve, që kryesisht mbahen në Bruksel, mund të organizohen takime të tjera zyrtare dhe joformale.

### ***3.1.3. Pjesëmarrja në forumet ndërparlamentare të parlamenteve të vendeve anëtare të BE-së***

*Takimet e përbashkëta të komisioneve (TPK) dhe takimet e përbashkëta parlamentare (TPP)*

Takimet e përbashkëta të komisioneve (TPK) dhe takimet e përbashkëta parlamentare (TPP) organizohen bashkërisht nga Parlamenti Evropian dhe Parlamenti Kombëtar i shtetit anëtar që mban Presidencën e BE-së. Këto takime, gjithashtu, bashkë-kryesohen, në rast të takimeve të përbashkëta parlamentare (TPP) nga kryetarët e parlamenteve, dhe në rastet e takimeve të përbashkëta të komisioneve (TPK), nga kryesuesit e komisioneve përkatëse të parlamenteve kombëtare dhe të PE-së. Në përgjithësi, përkthimi ofrohet në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së. Takimet e përbashkëta parlamentare u prezantuan në vitin 2005, në kuadrin e "Periudhës së reflektimit të BE-së", për të siguruar dialogun parlamentar dhe për të larguar BE-në nga ngërçi, pas refuzimit të projekt-Kushtetutës. Që nga hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës, temat kryesore të TPP-ve, kanë lëvizur në çështje më specifike, siç janë çështjet e energjisë, çështjet mjedisore apo çështjet që kanë të bëjnë me ekonominë dhe rritjen e qëndrueshme.

Takimet e përbashkëta të komisioneve i bëjnë bashkë anëtarët e parlamenteve nacionale dhe anëtarët e Parlamentit Evropian, nga komisionet përkatëse, për të diskutuar çështje të shqetësimeve të përbashkëta. Secili parlament mund të dërgojë deri në 4 anëtarë, ndërsa delegacionet e PE-së varen nga numri i deputetëve që ka komisioni i përfshirë.

*Konferenca e komisioneve të parlamenteve kombëtare të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, që merren me çështjet e Bashkimit Evropian dhe përfaqësuesit e Parlamentit Evropian (COSAC)*

Një mjet i rëndësishëm i parlamenteve kombëtare për koordinimin në çështjet evropiane është COSAC, që është një konferencë e komisioneve të parlamenteve kombëtare të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, që merren me çështjet e Bashkimit Evropian, si dhe përfaqësuesit e Parlamentit Evropian.

Ajo i mbledh së bashku delegacionet nga komisionet e çështjeve evropiane dhe sekretariatet e tyre, të shteteve anëtare dhe të vendeve candidate, si dhe vetë Parlamenti Evropian është i përfaqësuar aty. Sipas Protokollit të Traktatit të Lisbonës për rolin e parlamenteve kombëtare, COSAC mund të japë çdo kontribut për vëmendjen e Parlamentit Evropian, të Këshillit ose të

Komisionit Evropian. Përveç kësaj, konferenca synon të promovojë shkëmbimin e informacionit dhe të praktikave më të mira midis parlamenteve kombëtare dhe PE-së.

COSAC takohet dy herë gjatë çdo Presidence të BE-së, në një semestër. Fillimisht, takohen kryesuesit dhe pastaj mbahet seanca plenare e COSAC-ut, ku 6 pjesëtarë të komisioneve të çështjeve të Bashkimit Evropian mund të marrin pjesë më së shumti nga çdo parlament. PE-ja përfaqësohet nga një prej nënkryetarëve të saj, që është përgjegjës për marrëdhëniet me parlamentet kombëtare, nga kryetari i Komisionit Kushtetues të PE-së dhe nga katër anëtarë të tjerë, të zgjedhur sipas temës në rendin e ditës dhe duke respektuar balancën politike. Tre anëtarë të Parlamentit të çdo vendi kandidat mund të marrin pjesë në mbledhje plenare, si vëzhgues, ndërsa dy anëtarë mund të marrin pjesë në mbledhjen e kryesuesve.

Duke marrë parasysh që Kosova e ka statusin kandidatit potencial, kryesuesit përkatës të komisioneve përkatëse mund të dërgojnë një letër zyrtare, që përmban argumente dhe duke kërkuar mundësinë për të marrë pjesë si vëzhgues, në këto takime (të Parlamentit Evropian apo të Parlamentit të vendit, që e mban Presidencën e radhës). Me pjesëmarrjen në këto takime që i bashkon anëtarët e parlamenteve kombëtare dhe Parlamentin Evropian, anëtarët e Kuvendit të Kosovës mund të përfaqësojnë interesin e vendit. Pjesëmarrësit mund të mbështeten dhe t'i forcojnë marrëdhëniet politike midis deputetëve kombëtarë dhe deputetëve të PE-së.

### **3.2. Forcimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me asamblatë ndërparlamentare**

Kuvendi i Kosovës merr pjesë, nëpërmjet delegacioneve të emëruara, në një sërë mekanizmesh parlamentar; të organizatave ndërkombëtare. Deri tani, megjithatë, këto delegacione nuk kanë bashkëpunuar me komisionet relevante parlamentare, për t'i informuar për aktivitetet diplomatike dhe sfidat që hasin në punën e tyre, në mënyrë që të bashkërendohen aktivitetet parlamentare në drejtim të fuqizimit ndërkombëtar të Kosovës. Prandaj, rekomandohet që për përbërjen e delegacioneve të konsultohet edhe Komisioni për Punë të Jashtme dhe Komisioni për Integritet Evropian dhe pastaj këto delegacione të njoftojnë vazhdimisht komisionet e lartpërmendura për punën e tyre, në mënyrë që të arrihet koordinim më i mirë i diplomacisë parlamentare.

#### **3.2.1. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (AP e KE)**

Rezoluta e Këshillit të Evropës 2094/2016, deklaron që Kosova është njohur si shtet sovran dhe i pavarur nga 34 shtete anëtare të Këshillit të Evropës, megjithatë 13 shtete anëtare të Këshillit të Evropës ende nuk e kanë njohur Kosovën. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës vendos të intensifikojë dialogun me Kuvendin e Kosovës dhe rekomandon që Byroja e saj të modifikojë formatin e bashkëpunimit me forcat politike të zgjedhura në Kuvendin e Kosovës, me qëllim që t'i bëjë thirrje Kuvendit të Kosovës për të caktuar një delegacion që do të sigurojë përfaqësimin edhe të komuniteteve pakicë, përveç shumicës dhe opozitës.

Më 5 shtator 2016, Byroja e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës mori vendim për të zbatuar gjetjet e rezolutës së lartpërmendur, për të rritur nivelin e bashkëpunimit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës me Kuvendin e Kosovës. Rrjedhimisht, që nga janari 2017, Kuvendi i Kosovës ka të drejtë të dërgojë 3 anëtarë me përfaqësimin e përfaqësuesve të pushtetit, opozitës dhe minoriteteve.



Duke pasur një status të veçantë në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, i jep Kosovës një mundësi të madhe për të përfaqësuar interesin e saj kombëtar, prandaj mund të vihet në veprim një aktivitet i fortë i lobimit. Kosova mund të përfitojë nga ky status i posaçëm, për të ndikuar në opinionin e atyre shteteve anëtare të Këshillit të Evropës që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Marrja e këtij statusi të posaçëm në Asamblenë Parlamentare të KE-së mund të shtojë gjasat për anëtarësimin e Kosovës në institucione të tjera ndërkombëtare, pasi që kjo mund të përdoret si referencë. Prania e vazhdueshme e politikanëve të Kosovës jep një mundësi të mirë për të përfituar nga ky status dhe për të ecur përpara dhe për të arritur një nivel të shtuar të bashkëpunimit. Prania dhe aktiviteti lobues i politikanëve ofrojnë një mundësi për t'i afruar aktorët politikë ndërkombëtarë me interesat e Kosovës. Kjo situatë është një mundësi e shkëlqyer për Kosovën, për të ndërtuar partneritete të reja dhe për t'i forcuar ato ekzistuese.

Kuvendi i Kosovës duhet të krijojë një delegacion të përhershëm në Asamblenë Parlamentare të KE-së, për të cilin duhet të zgjidhen tre anëtarë të përhershëm. Anëtarët e delegacionit duhet të kenë aftësi të duhura gjuhësore, kryesisht anglisht dhe /ose frëngjisht, në mënyrë që të jenë në gjendje të përfaqësojnë dhe llojnë për interesin e Kosovës gjatë takimeve formale dhe joformale, në mënyrë të barabartë. Delegacioni duhet të shoqërohet nga një sekretar nga administrata. Për më tepër, në momentin që Kosova aplikon për anëtarësim në Këshillin e Evropës, Kryesia duhet të miratojë një delegacion shtesë, që përbëhet kryesisht nga deputetë me përvojë në fushën e politikës së jashtme, meqë duhet të shumëfishohen aktivitetet diplomatike në raport me anëtarët e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

### **3.2.2. *Asambleja Parlamentare e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (AP e NATO-s)***

Asambleja Parlamentare e NATO-s siguron një forum unik të specializuar për deputetët nga e gjithë Aleanca Atlantike, për të diskutuar dhe ndikuar në vendimet mbi sigurinë e Aleancës. Përmes punës dhe aktiviteteve të saj, Asambleja lehtëson vetëdijësimin parlamentar dhe të kuptuarit e çështjeve kryesore, që ndikojnë në sigurinë e zonës euroatlantike dhe e mbështet mbikëqyrjen parlamentare kombëtare mbi mbrojtjen dhe sigurinë. Çështje thelbësore është që ajo ndihmon në forcimin e marrëdhënieve transatlantike dhe të vlerave themelore të Aleancës. Kuvendi i Kosovës ka fituar statusin e vëzhguesit në Asamblenë Parlamentare të NATO-s në vitin 2014. Delegacioni i Kuvendit të Kosovës përbëhet nga dy anëtarë (një nga pozita, një nga komunitetet pakicë).

Delegacioni i Kosovës ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e komiteteve, ka të drejtë të flasë, por jo të votojë. Komiteti i vetëm, në të cilin delegacioni i Kosovës nuk ka të drejtë të marrë pjesë, është Komiteti i Përhershëm.

Statusi i vëzhguesit siguron mundësinë që delegacioni i Kuvendit të Kosovës të mbajë kontakte të rregullta me delegacionet e tjera në AP të NATO-s. Me qëllim të përforcimit të prezencës si vëzhgues, pasi që sipas Rregullores së Punës së AP të NATO-s, delegacionet mysafire mund të marrin pjesë dhe të flasin në mbledhjet e komiteteve të Asamblesë, është shumë e rekomandueshme të shfrytëzohet kjo mundësi dhe të merret fjala sa më shpesh, që është e mundur. Duke e marrë parasysh situatën e Kosovës, anëtarët e delegacionit duhet të marrin pjesë aktive në punën e komiteteve si vijon:

- Komiteti për Dimensionin Civil të Sigurisë;
- Komiteti për Mbrojtje dhe Siguri;
- Komiteti Politik;
- Komiteti për Ekonomi dhe Siguri.

Gjithashtu, është e këshillueshme që këto komitete ose nënkomitetet e tyre të ftohen për të mbajtur takime në Kosovë. Këto takime mund të ofrojnë një mundësi unike për politikanët e rangut të lartë për takime personale dhe shkëmbimin e pikëpamjeve me politikanët e lartë të AP të NATO-s.

Kuvendi i Kosovës duhet të krijojë një delegacion të përhershëm në AP të NATO-s, për të cilin duhet të zgjidhen dy anëtarë të përhershëm. Anëtarët e delegacionit duhet të kenë aftësi të duhura gjuhësore, kryesisht anglisht dhe /ose frëngjisht, për të qenë në gjendje të përfaqësojnë dhe llojnë për interesin e Kosovës, gjatë takimeve formale dhe joformale, në mënyrë të barabartë. Delegacioni duhet të shoqërohet nga një sekretar nga administrata (Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare).

### ***3.2.3. Asambleja Parlamentare e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (AP e OSBE-së)***

OSBE-ja e ka origjinën e saj në fazën e uljes së tensioneve, në fillim të viteve 1970, kur Konferenca për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (KSBE), u krijua për të shërbyer si një forum shumëpalësh për dialog dhe negociata ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit. Duke u takuar për dy vjet në Helsinki dhe në Gjenevë, KSBE-ja arriti marrëveshje mbi Aktin Final të Helsinkit, i cili u nënshkrua më 1 gusht 1975. Më 1994, KSBE u riemërua si Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, për shkak të rolit të zgjeruar të organizatës.

Asambleja Parlamentare e OSBE-së është një institucion kyç i organizatës, duke ofruar vazhdimisht ide dhe propozime të reja, aktualisht e përbërë nga 56 parlamente. Si parakusht për marrjen e statusit të vëzhguesit në AP të OSBE-së është që vendi duhet të bëhet partner i OSBE-së. Rekomandohet që Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës të ndërmarrin përpjekje të përbashkëta, në të gjitha forumet e mundshme ndërkombëtare, duke përfshirë aktivitetet dypalëshe. Gjatë planifikimit dhe realizimit të marrëdhënieve dypalëshe, Qeveria dhe Kuvendi duhet të punojnë së bashku, në mënyrë të harmonizuar dhe të koordinuar. Koordinimi mund të vihet në praktikë në nivelin politik, përmes Komisionit për Punë të Jashtme.

### ***3.2.4. Unioni Ndërparlamentar (IPU)***

Unioni Ndërparlamentar është një organizatë unike mbarë botërore e parlamenteve kombëtare. Çdo parlament, i themeluar në përputhje me ligjet e një shteti sovran, popullsinë e të cilit e përfaqëson dhe në territorin e të cilit funksionon ai, mund të kërkojë anëtarësim në Unionin Ndërparlamentar. Njohja diplomatike e Kosovës është një parakusht i anëtarësimit të plotë në IPU.

Pasi që Komiteti Ekzekutiv i IPU-së përgatit propozimin e vendimit për anëtarësim për Këshillin Drejtues, në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe, Kuvendi i Kosovës duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë lobimit, sidomos në parlamentet e përfaqësuara në Komitetin Ekzekutiv. Në këtë drejtim, në takimet ose vizitat ndërkombëtare të Kryetarit, të anëtarëve të Kryesisë, të Komisionit për Punë të Jashtme dhe të grupeve të miqësisë, duhet të realizohen aktivitete të veçanta lobimi në parlamentet e përfaqësuara në Komitetin Ekzekutiv të IPU-së. Hapat e parë fillestarë për vendosjen e marrëdhënieve mund të bëhen edhe nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Kosovës, në formën e konsultimeve dypalëshe me sekretarin e Përgjithshëm të IPU-së në Gjenevë. Komisioni për Punë të Jashtme rekomandon që menjëherë të bëhen hapat e parë drejt përgatitjes së aplikacionit të Kuvendit të Kosovës për anëtarësim në këtë organizatë të rëndësishme parlamentare.

### **3.2.5. Bashkëpunimi me gjeografitë tjera jashtë Evropës**

Përpos bashkëpunimit me forumet dhe asambljetë parlamentare të Evropës, Kuvendi i Kosovës duhet të fuqizojë prezencën e vet edhe në forumet tjera ndërkombëtare parlamentare. Duhet të shihet mundësia për realizimin e qasjeve të veçanta dhe krijimin e lidhjeve me organizata dhe mekanizma shumëpalësh, si PARLATINO, PARLACEN, Parlamentit Pan-Afrikan, ASEAN Inter-Parliamentary Assembly (AIPA), etj. Për më tepër, Kuvendi duhet të vazhdojë pjesëmarrjen në forume të tjera, siç është Rrjeti Global Parlamentar i Bankës Botërore dhe FMN-së dhe mekanizma të tjerë të ngjashëm. Grupi i Grave Deputete dhe Grupi i Deputetëve të Rinj duhet të shikojnë mundësinë e anëtarësimit në mekanizma parlamentarë global apo rajonal, që kanë të bëjnë me fuqizimin e grave dhe të rinjve.

### **3.3. Aspiratat rajonale të Kuvendit të Kosovës**

Një nga elementet kryesore të politikës së jashtme të Kosovës është pjesëmarrja aktive në organizatat e bashkëpunimit rajonal. Kosova ka bashkëpunim bilateral të mirë, me shumicën e vendeve të rajonit, kështu që kjo situatë mund të përdoret lehtësisht për të promovuar interesat e saj në organizatat rajonale. Kuvendi i Kosovës duhet të përdorë çdo mundësi, për të marrë pjesë në organizatat, takimet dhe konferencat rajonale. Çdo takim ku marrin pjesë deputetët kosovarë, është me rëndësi të veçantë në lidhje me statusin dhe imazhin ndërkombëtar të vendit.

Bashkëpunimi rajonal është një fushë e mirë për Kuvendin e Kosovës, pasi që vendet e rajonit kanë një numër të madh çështjesh dhe interesash të përbashkëta, si dhe çështje që duhen zgjidhur. Bashkëpunimi rajonal duhet të promovohet si një forum jashtëzakonisht i dobishëm, ku mund të arrihet besimi i përbashkët, mirëkuptimi i ndërsjellë dhe madje edhe konsensusi i mundshëm mbi çështjet e debatuar.

#### *Forumi Parlamentar i Cetinës(FPC)*

Forumi Parlamentar i Cetinës u themelua në vitin 2004, për të inkurajuar dhe promovuar dialogun parlamentar midis vendeve të rajonit. Qëllimi i FPC-së është të nxisë bashkëpunimin, të transferojë njohuritë dhe përvojën dhe të forcojë marrëdhëniet, në mënyrë që të ruhet vazhdimësia në drejtim të bashkëpunimit më të ngushtë parlamentar dhe diplomacisë në rajon, të përmirësojë marrëdhëniet dypalëshe dhe shumëpalëshe, si dhe të bashkojë përfaqësuesit e institucioneve legjislative në vendet që ndajnë trashëgiminë e përbashkët historike dhe kulturore dhe perspektivën evropiane. FPC ofron mundësinë për të këmbyer përvojat dhe praktikat më të mira dhe për të racionalizuar punën parlamentare, veçanërisht në lidhje me transpozimin e standardeve të BE-së në legjisllacionin kombëtar dhe në çështje të tjera me interes të përbashkët rajonal. Kosova është anëtare e Forunit.

#### *Asambleja Parlamentare e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (AP e PBEJL)*

Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore është një forum për dialogun diplomatik dhe politik. Ai shpreh vullnetin e vendeve pjesëmarrëse për të filluar një proces afatgjatë të bashkëpunimit shumëpalësh në fushat e forcimit të stabilitetit, të sigurisë dhe të marrëdhënieve të mira fqinjësore; zhvillimit ekonomik; humanitar, social dhe kulturor;

drejtësisë, luftës kundër krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm të drogës dhe të armëve, dhe terrorizmit.

Asambleja Parlamentare synon të transformojë dimensionin ad-hoc parlamentar të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, në një forum të përhershëm ndërparlamentar. Sesioni i inaugurimit të Asamblesë Parlamentare të PBEJL-së, i mbledhi parlamentet nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Sllovenia, Turqia dhe *Kosova*, si një mysafir special i kryetarit në detyrë të PBEJL-së (Rumani), në atë kohë. Në vitin 2014, Samiti i Bukureshtit vendosi të ftojë Kosovën për të marrë pjesë në mënyrë të përhershme në aktivitetet e PBEJL-së në të gjitha nivelet dhe në kushte të barabarta.

#### *Konferenca e Komisioneve Parlamentare të Integritit Evropian të shteteve pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizim-Asocimit (COSAP)*

Duke ndjekur shembullin e COSAC-ut, pjesëmarrësit e Konferencës së Kryesuesve të Komisioneve për Punë të Jashtme dhe Komisioneve të Integritit Evropian të parlamenteve kombëtare të vendeve pjesëmarrëse në Procesin e Evropës Juglindore (PBEJL), vendosën në vitin 2005 të krijojnë një formë rajonale të bashkëpunimit parlamentar të komisioneve të çështjeve evropiane, si një mjet për të promovuar reformat themelore të brendshme, përmes ndjekjes së përbashkët të integritit në BE.

Konferenca ka një kryesim me rotacion, që mbahet sipas renditjes alfabetike nga kryetari i Komisionit për Çështje Evropiane të vendit kryesues dhe takohet rregullisht për të diskutuar çështjet që lidhen me Procesin e Stabilizim-Asociimit dhe me zgjerimin e BE-së.

Kuvendi i Kosovës, aktualisht ka statusin e vëzhguesit në COSAP. Për të fituar statusin e anëtarit, ekziston nevoja për aktivitete lobimi politik të vazhdueshëm, në baza dypalëshe, me të gjitha vendet që marrin pjesë në COSAP.

#### *Dimensioni parlamentar i Iniciativës së Evropës Qendrore (IEQ)*

Qëllimet kryesore të Iniciativës së Evropës Qendrore janë forcimi i bashkëpunimit shumëpalësh ndërmjet shteteve anëtare të IEQ-it, në nivel parlamentar, krijimi dhe thellimi i strukturave të partneritetit, bazuar në parimet e demokracisë parlamentare dhe respektimin e të drejtave të njeriut. IEQ, aktualisht i ka 18 anëtarë.

Standardi që zbatohet si anëtar të Dimensionit Parlamentar është i njëjtë, sikurse me anëtarësimin në Këshillin e Evropës. Përfaqësuesit e asambleve të tjera ndërkombëtare dhe parlamentet kombëtare të vendeve jo-anëtare të IEQ-it, zyrtarët qeveritarë, OJQ-të, etj., mund të ftohen si mysafirë nga Presidenti i Dimensionit Parlamentar, me informimin paraprak të delegacioneve kombëtare. Kuvendi i Kosovës duhet të punojë ngushtë me Qeverinë për marrjen e statusit të mysafirit në këtë organizatë.

#### *Dimensioni parlamentar i Iniciativës Adriatiko-Joniane (IAJ)*

Iniciativa Adriatiko-Joniane (IAJ), u krijua në vitin 2000 dhe në të marrin pjesë kryetarët e shteteve dhe të qeverive të Italisë, Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Greqisë dhe Sllovenisë, për të forcuar bashkëpunimin rajonal, duke promovuar stabilitetin politik dhe ekonomik, duke krijuar kështu një bazë solide për procesin e integritit evropian. Sot, IAJ numëron tetë anëtarë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Greqia, Italia, Mali i Zi, Serbia dhe Sllovenia.

Dimensioni parlamentar i IAJ-së është një lidhje e rëndësishme midis strategjive makro-rajonale dhe shoqërisë në tërësi, në nivel rajonal, kombëtar dhe evropian. Pra, përfaqëson parimin e subsidiaritetit, duke qenë se parlamentet janë institucionet më pranë qytetarëve. Sa i përket pjesëmarrjes në këtë bashkëpunim, Kuvendi i Kosovës duhet të punojë ngushtë me Qeverinë për sigurimin e anëtarësimit në këtë organizatë.

Në pajtim me zhvillimet e fundit, ekspertët besojnë që Kuvendi i Kosovës duhet të përqendrohet kryesisht në ato forume, në të cilat ajo ka statusin e anëtarit, siç është Forumi Parlamentar i Cetinës (FPC) dhe aty ku Kosova ka statusin e vëzhguesit, siç është Konferenca e Komisioneve Parlamentare të Integritimit Evropian të shteteve pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizim-Asociimit (COSAP).

### **3.4. Marrëdhëniet bilaterale**

Me qëllim të promovimit të realizimit të qëllimeve strategjike të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës, theks i veçantë duhet të vihet edhe në marrëdhëniet dypalëshe. Për këtë qëllim, ekziston nevoja për harmonizim të rregullt ndërmjet drejtimeve të marrëdhënieve bilaterale parlamentare dhe aktiviteteve aktuale të politikës së jashtme të Qeverisë në fushat e mëposhtme: marrëdhëniet me vendet fqinje; marrëdhëniet me parlamentet kombëtare të BE-së, me theks të veçantë në ato ku Kosova ende nuk është njohur; marrëdhëniet me shtetet anëtare të organizatave parlamentare ndërkombëtare, me theks të veçantë në ato vende ku Kosova planifikon të fitojë (ose të përmirësojë) çdo lloj statusi të mundshëm; marrëdhëniet me parlamentet e vendeve kryesore donatore, siç është Kongresi i Shteteve të Bashkuara (Senati dhe Dhoma e Përfaqësuesve), Bundestagu gjerman, etj.

Për t'i përbushur qëllimet strategjike të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës, marrëdhëniet parlamentare dypalëshe duhet të planifikohen në mënyrë strategjike. Mënyrat e mundshme të forcimit të marrëdhënieve dypalëshe në emër të Kuvendit janë për shembull vizitat bilaterale të aktorëve politikë të niveleve të ndryshme, pjesëmarrja në ngjarjet ndërkombëtare, por edhe dialogu i zyrtarëve, si dhe korrespondenca proaktive, për të ndërtuar mirëbesimin. Në bashkëpunimin parlamentar, të gjitha nivelet e ndryshme të marrëdhënieve duhet të forcohen dhe të mbështeten. Te politikanët partnerë të nivelit më të lartë, mund të arrihet përmes përfshirjes aktive të Kryetarit, Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe Komisionit për Punë të Jashtme, prandaj këtyre marrëdhënieve duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë. Në të njëjtën kohë, është gjithashtu e domosdoshme të ndërtohet një marrëdhënie pozitive dhe aktive midis deputetëve dhe partnerëve të tyre ndërkombëtarë. Komisionet e posaçme të Kuvendit të Kosovës mund t'i ftojnë komisionet partnere nga jashtë, gjithashtu mund t'i iniciojnë udhëtimet e tyre zyrtare në një vend të caktuar, ku ekzistojnë interesa të veçanta.

Grupet parlamentare të miqësisë mund të jenë, gjithashtu, mjete të dobishme. Pasi që anëtarë të grupeve mund të jenë anëtarët e komisioneve të ndryshme parlamentare, kur të vizitojnë një parlament partner, mund të preken tema të ndryshme të rëndësishme. Një dialog aktiv midis anëtarëve të grupit të miqësisë dhe ambasadorëve të vendit përkatës në Kosovë, gjithashtu është një instrument i mirë për të fituar njohuri për gjendjen aktuale të atij vendi dhe për mjedisin ndërkombëtar.

Komisioni për Punë të Jashtme realizon shumicën e vizitave të karakterit politik dhe përfaqësues të Kuvendit të Kosovës, jashtë vendit, prandaj edhe fokusi kryesor i vizitave duhet të përqendrohet te ky komision.

Marrëdhëniet parlamentare mund të forcohen nga pjesëmarrja aktive në ngjarje ndërkombëtare, raste festive ose konferenca. Këto janë mjete të rëndësishme për rritjen e dukshmërisë së vendit dhe për forcimin e dialogut ndërmjet parlamentarëve, prandaj duhet të mbështeten. Vizitat studimore të deputetëve dhe anëtarëve të stafit në parlamente të ndryshme të huaja mund t'i përmirësojnë marrëdhëniet dypalëshe, pasi që ato ofrojnë një mundësi të mirë, për të realizuar më shumë mundësi për bashkëpunim të mëtejshëm.

Organizimi i konferencave ose seminareve është një mjet i shkëlqyeshëm, për të ftuar politikanë nga vende të ndryshme në Kosovë, prandaj kjo është një mundësi e mirë për të forcuar reputacionin e mirë të mikpritësit. Temat e zgjedhura mirë dhe folësit kryesorë mund të tërheqin shumë politikanë të nivelit të lartë dhe kjo mund të përdoret, gjithashtu, për të pasur bisedime dypalëshe prapa skenave, duke promovuar, gjithashtu, realizimin e qëllimeve strategjike të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës. Konferencat ose seminarët mund të organizohen së bashku me institucione ose parlamente të tjera, ose vetëm nga Kuvendi i Kosovës.

Gjithashtu, marrëdhëniet midis deputetëve dhe ambasadorëve të akredituar në Kosovë mund të intensifikohen, pasi ato shërbejnë si një mjet i mirë për ndërtimin e besimit të ndërsjellë.

Kultivimi i marrëdhënieve dypalëshe mund të jetë një instrument i dobishëm edhe për ta ndihmuar aktivitetin lobues për sigurimin e statusit të dëshiruar në organizatat ndërkombëtare. Theksi duhet të vihet në planifikimin strategjik dhe realizimin e vizitave jashtë vendit dhe pranimin e delegacioneve të huaja.

Korniza aktuale në fuqi, e cila lejon udhëtimet e deputetëve, vetëm në rast të ftesave nga parlamentet e shteteve të tjera, kufizon mundësinë e fuqizimit të marrëdhënieve bilaterale në raste kur ftesat mund të vijnë nga organe të tjera shtetërore, por që ofrojnë mundësi të mira të zhvillimit të raporteve me shtete njohëse apo jo-njohëse. Prandaj, duke pasur parasysh rëndësinë e zhvillimit të diplomacisë parlamentare, duhet të rishikohet kjo kornizë dhe të bëhet më fleksibile, në rast të kërkesave nga Komisioni për Punë të Jashtme dhe Komisioni për Integritet Evropian.

### **3.5. Ngritja dhe forcimi i strukturave të përhershme në Kuvendin e Kosovës për të siguruar përfaqësimin më efikas të interesave të Kosovës në nivelin parlamentar**

#### ***3.5.1. Roli i strukturave të përhershme në Kuvendin e Kosovës***

##### *Roli i delegacioneve të përhershme*

Është e këshillueshme që në fillim të çdo legjislature, Kuvendi t'i emërojë deputetët, për secilin delegacion, në asambletë parlamentare për tërë mandatin parlamentar. Anëtarësimi i përhershëm, në çdo delegacion parlamentar, krijon një bazë të mirë dhe mund të përmirësojë marrëdhëniet me anëtarët e tjerë dhe me vetë organizatën. Me anë të ndërveprimeve të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, marrëdhënia mund të thellohet dhe mund të zhvillohet në një fazë të mëtejshme. Anëtarët e delegacioneve të përhershme, pas çdo vizite ose pjesëmarrje jashtë, njoftojnë Kryesinë e Kuvendit dhe Komisionin për Punë të Jashtme, verbalisht ose me shkrim, rreth takimeve të realizuara dhe çështjeve me interes.

Sekretarët e përhershëm duhet të mbështesin dhe të ndihmojnë punën e delegacioneve të përhershme. Nga sekretarët e përhershëm mund të bëhen punë përgatitore të standardeve më

të larta, që mund të kenë rol kyç, si gjatë realizimit të vizitës, ashtu edhe pas vizitës. Sekretarët e përhershëm duhet të shërbejnë si bazë për vazhdimësinë e punës dhe mund të jenë bazë e njohurive institucionale.

### **3.5.2. Bashkëpunimi me ministrinë relevante**

Për të forcuar politikën e jashtme të Kosovës dhe për të arritur qëllime të rëndësishme politike në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, Kuvendi i Kosovës duhet të bashkëpunojë me ministrinë përkatëse, kryesisht me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe me Ministrinë e Integritimit Evropian. Aktivitetet ndërkombëtare të Kuvendit të Kosovës duhet të jenë në përputhje me politikën e jashtme të vendit.

## **3.6. Konkluzion**

Në përputhje me synimet strategjike të politikës së jashtme të Kosovës, rekomandohet që Kuvendi i Kosovës të luajë një rol aktiv në fushën ndërkombëtare. Për ta arritur këtë qëllim, Kuvendi i Kosovës duhet të bashkëpunojë me parlamentet anëtare të asambleve ndërparlamentare, si dhe me organizata të ndryshme ndërkombëtare. Në rast të statusit si i ftuar ose si vëzhgues, Kuvendi i Kosovës duhet të forcojë pozicionin e tij dhe të jetë sa më aktiv që është e mundur. Megjithatë, sigurimi i anëtarësimit (gjithashtu në rastin e statusit si i ftuar ose si vëzhgues) është një hap i rëndësishëm në rrugën e integritimit euroatlantik, gjithashtu anëtarësimi përmban në vete edhe disa detyrime të caktuara.

Kuvendi i Kosovës duhet të punojë për këto anëtarësime, në një perspektivë afatgjatë, pavarësisht nga situata e brendshme politike. Kuvendi i Kosovës duhet të jetë në gjendje të përmbush në afat të gjatë të gjitha kriteret që kërkohen për anëtarësim (si vëzhgues ose me statusin e të ftuarit), në mënyrë që të shmangen pasojat e mospërmbushjes, si p.sh: borxhet e pa paguara.

Në aspektin strategjik, prioritetet kryesore duhet të përcaktohen në aktivitetet e mëposhtme ndërkombëtare:

- Bashkëpunimi me Parlamentin Evropian;
- Bashkëpunimi me Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës;
- Bashkëpunimi me AP të NATO-s;
- Bashkëpunimi me AP të OSBE-së;
- Konferencat e Parlamentit Evropian për Komisione për Punë të Jashtme;
- Konferenca e Komisioneve Parlamentare të Integritimit Evropian të Shteteve pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizim Asociimit (COSAP);
- Forumi Parlamentar i Cetinës;
- Dimensioni parlamentar i SEECP, CEI, etj.;
- Bashkëpunimi me Global Parliamentary Network of the World Bank & IMF;
- Krijimi i lidhjeve me organizata dhe mekanizma shumëpalësh si:
  - IPU
  - PARLATINO
  - PARLACEN
  - Parlamentit Pan-Afrikan
  - ASEAN Inter-Parliamentary Assembly (AIPA);
- Bashkëpunimi me vendet fqinje;

- Bashkëpunimi me vendet e BE-së, me theks të veçantë, në ato vende që ende nuk e kanë njohur Kosovën;
- Bashkëpunimi me parlamentet e vendeve kryesore donatore;
- Bashkëpunimi me parlamentet e vendeve jashtë BE-së, që nuk e kanë njohur Kosovën;
- Funkcionalizimi i grupeve të miqësisë në Kuvendin e Kosovës dhe koordinimi me rrjetin e shërbimit të jashtëm të Kosovës, që grupe homologe të miqësisë të krijohen në parlamentet përkatëse.

Në mënyrë që të zhvillohet një politikë e jashtme efektive, do të ishte e këshillueshme nëse në çështjet strategjike kryesore, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Integritimit Evropian, do t'i përfshinin anëtarët e Kuvendit të Kosovës në delegacionet e tyre negociuese dhe grupet e tyre punuese.

Këto ministri, me kërkesë të Kuvendit të Kosovës, duhet të sigurojnë informacion, dokumente (për marrëdhëniet dypalëshe politike dhe ekonomike me vendin në fjalë, informacion mbi politikën e brendshme dhe gjendjen ekonomike, informacion mbi politikën e jashtme, si dhe politikën e integritimit evropian, nëse është e përshtatshme, të vendit të caktuar), gjithashtu pika të fjalimeve, përmes Drejtorisë për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare.

#### **IV. PROPOZIMET PËR KORNIZËN RREGULLATORE PËR MENAXHIMIN E MARRËDHËNIEVE NDËRKOMBËTARE DHE PROTOKOLLIT**

##### **4.1. Propozimet lidhur me strukturat administrative që merren me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe protokollin**

###### ***4.1.1. Propozimi për rritjen e stafit të Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike***

Përveç, që do të duhej të kishte statusin e komisionit të përhershëm, Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike duhet, po ashtu, t'i ndryshohet trajtimi, sa i përket stafit aktual. Ky komision ka vetëm koordinatorin dhe një nëpunës administrativ, edhe pse në këtë mandat i është trefishuar fushëveprimi. Prandaj, propozohet që të rritet stafi edhe për dy anëtarë, një këshilltar ose zyrtar i fushës së politikës së jashtme dhe një zyrtar që do të mbulojë diasporën dhe investimet strategjike. Në rrethanat aktuale dhe me stafin aktual, komisioni e ka shumë të vështirë të mbulojë të gjitha raportet dypalëshe e shumëpalëshe dhe shumë fusha të tjera që i ka në fushëveprim. Prandaj, në mënyrë që diplomacia parlamentare të zhvillohet si duhet, është e domosdoshme që të rritet numri i zyrtarëve në këtë komision.

###### ***4.1.2. Propozimet për specifikimin e detyrave dhe të përgjegjësive të sekretarëve të delegacioneve***

Për të garantuar organizimin e qetë të një vizite, roli dhe përgjegjësitë e sekretarëve të delegacioneve duhet të përcaktohen siç duhet. Sekretarët e delegacioneve duhet të luajnë rol kyç në përgatitjen dhe realizimin e vizitave, pavarësisht se cila njësi e Kuvendit të Kosovës e propozon sekretar-in/en e delegacionit. Detyrat e tyre fillojnë me detyrat administrative të dorëzimit të dokumentacionit të duhur për miratimin e vizitës, duke bërë aranzhime udhëtimi



(përfshirë transportin në vendin e vizituar, rezervimet e hotelit, marrjen e vizave, informimin e ambasadave të Kosovës etj.). Sekretarët e delegacioneve janë përgjegjës për kërkimin e materialeve bazë nga ministritë relevante, agjencitë qeveritare dhe institucionet, në varësi të temës së bisedimeve të planifikuara gjatë vizitës në fjalë dhe përgatitjen e pikave të diskutimit për delegacionin. Pas kthimit nga vizita, sekretarët e delegacioneve duhet të përgatisin një raport për vizitën dhe të sigurojnë miratimin dhe shpërndarjen e tij. Raportet duhet t'i shpërndahen Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, Komisionit për Punë të Jashtme dhe Komisionit për Integritime Evropiane (në rast se vizita lidhet me çështje të integritimit evropian), si dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Integritimit Evropian, në rast se Kryesia dhe komisionet e shohin të nevojshme.

#### **4.2. Planifikimi strategjik i marrëdhënieve ndërkombëtare**

Kohët e fundit, aktivitetet ndërkombëtare të Kuvendit të Kosovës nuk janë planifikuar përpara, por më tepër janë zhvilluar në baza *ad-hoc*. Për të forcuar pozitën e Kosovës në fushën ndërkombëtare, planifikimi i duhur i vizitave dhe udhëtimeve të ndryshme është i domosdoshëm. Për këtë arsye, çdo fillim vit, Kryesia e Kuvendit, në bashkëpunim me Komisionin për Punë të Jashtme dhe Komisionin për Integritime Evropiane, do të duhej të përgatiste një draft-plan vjetor, i cili do të përfshinte vizitat që janë prioritet për atë vit. Natyrisht, kjo nuk do të përjashtonte pastaj vizitat e tjera, të cilat Kryesia apo komisionet do t'i realizonin përgjatë vitit, varësisht nga ftesat dhe nga zhvillimet. Ky plan do t'i bënte aktivitetet ndërkombëtare të Kuvendit të Kosovës, më të qëndrueshme dhe më të parashikueshme. Në të njëjtën kohë, duhet të garantohet fleksibiliteti në planin vjetor të autorizimit, pasi që mund të ketë ngjarje të rëndësishme të paparashikueshme ndërkombëtare, që do të kërkonin vendime të menjëhershme. Në rast të aktiviteteve të financuara vetë, vendimi duhet të merret nga Kryesia, ndërsa në rast të aktiviteteve të financuara nga donatorët, do të jetë Kryetari ai që e merr vendimin. Ngjarjet e përfshira dhe të miratuara një herë në planin e autorizimit nuk duhet të kenë nevojë për miratim të mëtejshëm, dhe në këtë mënyrë, planifikimi financiar do të bëhet më i lehtë, pa nevojën e vazhdueshme të rialokimit të fondeve. Ndërkaq, për vizitat që nuk kanë qenë të planifikuara më herët, kërkesat që vijnë nga Komisioni për Punë të Jashtme dhe Komisioni për Integritime Evropiane, nuk do të duhej të kalonin procedura të stërzgjatura të shqyrtimit (në protokoll etj. , ku nganjëherë zgjasin deri dy muaj), por të trajtohen drejtpërdrejt në Kryesi. Për kërkesat që vijnë nga komisionet tjera, ose deputetët, në cilësi individuale, ato mund të kalojnë në procedura të rregullta, meqë politikën e jashtme nuk e kanë prioritet në fushëveprimin e tyre.

*Miratuar nga Kryesia e Kuvendit, Vendimi Nr: 06-V-439, datë 18 janar 2019*